



Duke u mbështetur në nenin 44 dhe të nenit 44.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, neni 6 të Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës së Klinës, më kërkesën e Kryetarit të Komunës, 01 Nr.06-178/2017 të dt. 17.01.2017, për caktimin dhe mbajtjen e seancës së Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës për dt.24.01.2017, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e Jashtëzakonshme të mbajtur më dt. 24.01.2017, mori këtë:

V E N D I M

Për vënie në diskutim publik të Draft-rregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave

- I Miratohet Vendimi për vënie në diskutim publik të Draft-rregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave.
- II Vënia në diskutim publik të Draft-rregullores komunale si me lartë bëhet me qëllimin e dhënies së kontributit nga të gjitha institucionet, ekspertët e fushës përkatëse dhe qytetarët që i njëjti të jetë sa më funksional nga subjektet implementues dhe të tjerë.
- III Brenda 15 ditëve të diskutimit publik të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës, personat fizikë dhe juridikë dhe të gjithë të interesuarit mund të marrin Draft-rregulloren e Menaxhimit të Mbeturinave në formë elektronike nga faqja zyrtare e komunës apo nga Shërbimi për punë të Kuvendit në formë elektronike.
- IV Vërejtjet dhe sugjerimet me shkrim mund të dorëzohen në Zyrën ligjore apo në Shërbimin profesional për Punë të Kuvendit.
- V Zyra ligjore dhe drejtoria përkatëse duhet të informojë Kuvendin me vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e dhëna duke përfshirë propozimet e refuzuara si dhe ato të marra parasysh konform dispozitave ligjore në fuqi.
- VI Kuvendi i Komunës propozimet e argumentuara dhe të mbështetura në ligj, të përfshira në tekstin përfundimtar të kësaj Rregulloreje do t'i ketë parasysh me miratimin e sajë.
- VII Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL në bazë të nenit 81 të LVL dhe nenit 18 të Rregullores së Qeverisë së RK Nr.01/2013

Vendimi është transparent përmes: Tabelës së shpalljeve dhe Zyrës për Informim .

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01 Nr. 06-281 /2017
Klinë, më 24.01 /2017

Kryesuesi
Dr. Haxhi Ibishi

